Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.
(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)
LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)
1	Switch Data Center	Copë	2		
2	Switch-e në Nyje	Copë	10		
3	Access Point	Copë	10		
4	Licensa shtesë për sistemin NAC (500 përdorues)	Set	1		
5	Implementim i projektit	Komplet	1		
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. GJENDJA AKTUALE

OST synon në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë rrjetin e komunikimit, regjistrimin, ruajtjen dhe qarkullimin e të dhënave. Kjo infrastrukturë konsiderohet nga OST si hallkë kryesore për sigurimin e mjeteve organizative dhe menaxheriale të cilat rrisin bashkëpunimin, transparencën dhe efektivitetin e administrimit të burimeve dhe aktiviteteve.

Sistemi TIK i OST sh.a. është një infrastrukturë komunikimi që mbulon të gjithë ambientet e OST (qendër dhe degë) dhe ofron qasje në internet dhe komunikim të sigurtë remote drejt shërbimeve të shoqërisë për të gjithë punonjësit.

Ky është një rrjet i sigurtë nga pikëpamja fizike dhe logjike në lidhjen e pajisjeve të ndryshme të infrastrukturës LAN, Switche, Wireless Access Point, Firewall dhe rrjetin e Serverave. Ky rrjet përdor standardet më të larta të sigurisë dhe mundëson identifikimin, sinjalizimin dhe parandalimin e rreziqeve si nga perimetri i jashtëm (WAN edge) ashtu edhe nga perimetri i brendshëm (aksesi përdoruesve, 802.1x bazuar në certifikatë, MAC Auth etj).

Lidhja midis qendrës dhe njësive operative me njëra-tjetrën realizohet duke shfrytëzuar infrastrukturën SDH të vetë OST sh.a.

Aktualisht këto pajisje punojnë me hardware/software të licensuar dhe me suport nga prodhuesi.

Për të realizuar misionin e tij, për të shtuar shërbimet dhe disponueshmërinë e tyre për personelin e saj, OST ka nevojë për mbështetjen me mjete dhe teknologji moderne të cilat ndihmojnë në mbledhjen, përpunimin, komunikimin në kohë reale dhe ruajtjen e sigurtë të informacionit. Infrastruktura aktuale nuk garanton përshkallëzueshmërinë e infrastrukturës së rrjetit. Prandaj është e nevojshme zëvendësimi i pajisjeve në nyje si dhe në Data Center për të realizuar këtë funksion.

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i këtij projekti është rishpërndarja dhe ngritja e një infrastrukture të konsoliduar hardware dhe software të Rrjetit (switch, wireless AP, NAC) për përmbushjen e detyrave funksionale të OST.

Në terma të përgjithshëm ky qëllim përfshin instalimin dhe konfigurimin e një rrjeti modern sipas standardeve më të fundit të industrisë, nga pikëpamja e network-ut të strukturuar për shërbimet e kërkuara të aksesit në rrjet, manaxhimit të politikave të sigurisë, sigurisë në rrjet, sigurisë dhe filtrimit të aksesit në Internet, monitorimit të aksesit dhe pajisjeve të rrjetit si dhe rishpërndarjen e pajisjeve wireless.

Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar objektivat si më poshtë:

- Upgrade i infrastrukturës së rrjetit me pajisje qendrore dhe periferike komunikimi, shpërndarje dhe akses.
- Ndërtimi i infrastrukturës pa kablo (wireless) për access point-et e rinj.
- Shtimi i kapaciteteve për të autentifikuar një numër më të madh asetesh në rrjet.
- Centralizimi i trafikut dhe segmentimi i tij.

3. REZULTATET E PRITSHME

Rezultatet kryesore të pritshme nga ky projekt janë:

- Rritje e kapaciteteve të OST në ofrimin e shërbimeve.
- Rritje e kapaciteteve përpunuese dhe ruajtëse të informacionit.
- Rritje e disponueshmërisë së shërbimeve.
- Përmirësim cilësor i shërbimeve të ofruara.
- Mbrojtje e perimetrave të sigurisë.
- Monitorim i aksesit.

4. ZGJIDHJA TEKNIKE E KËRKUAR

Rrjeti i komunikimit duhet të ofrojë siguri dhe disponueshmëri të lartë për transmetimin e të dhënave dhe komunikimet përgjatë gjithë infrastrukturës së kablluar, wireless, shërbimeve të ofruar në Data Center dhe aksesit në internet.

Arkitektura e re që do të integrohet me atë ekzistuese, në HQ dhe njësi operative dhe duhet të sigurojë një strukturë të aftë për të ofruar shërbime me cilësi të lartë dhe të besueshme, ku dështimi apo mungesa e një elementi të vetëm nuk do të shkaktojë ndonjë ndërprerje të komunikimit.

3.1 Topologjia e infrastrukturës me kablo dhe wireless

Topologjia e re duhet të përfshijë lidhjen në topologjinë Star të switcheve të aksesit me switch në Data Center, që duhet të jenë të konfiguruar në stack, si switchet e aksesit dhe ato në qendër. Switchet e aksesit në stack duhet të kenë lidhje redundante me qendrën, të cilat do të shërbejnë si uplink. Në qendër do të instalohen dhe konfigurohen switch-e për Data Center. Gjithashtu, switchet ekzistues të aksesit do të zëvendësohen me switche aksesit të rinj me kapacitet dhe performancë më të lartë. Për të rritur disponueshmërinë në rast dështimi të fibrave, switchet e aksesit në cluster duhet të lidhen me dy lidhje optike me switchet në data center që janë në cluster.




Figura 1 Topologjia e rrjetit Star - partial mesh

Të gjitha linket midis degëve dhe qendrës duhet të jenë lidhje optike me shpejtësi 10GbE mbi ndërfaqe Layer 3 dhe komunikimi duhet të jetë i bazuar mbi rutim. Duhet të eliminohet përhapja e VLAN-eve (Spanning) dhe Broadcast Domain midis godinave, duke eliminuar nevojën e përdorimit të protokolleve Layer 2 për parandalimin e loop-ave (STP dhe variantet e tjera) pra, duhet ndërtuar një rrjet redundant dhe loop-free.

Nevojiten protokolle dinamike rutimi midis nyjave për rrugëzim automatik në rast problemi (failure) të një nyje/linje/porte të veçantë. Rrugëzimi i ri dhe konvergjenca e kërkuar duhet të jetë automatike dhe të kryhet për një kohë sa më të shkurtër pa ndikuar në cilësinë e shërbimeve.

Për ndërtimin e infrastrukturës që do të integrohet me atë ekzistuese duhet të përdoret një teknologji “overlay”, e cila lejon ndërtimin e rrjetave logjike që mbështeten mbi rrjetin e përbashkët Layer 3. Kjo strukturë duhet të jetë e aftë të shtrijë këto rrjete logjike përgjatë gjithë rrjetit fizik që shtrihet në godina të ndryshme. Kjo zgjidhje ofron:

- Rrjete private të izoluar nga njëra-tjetra që shtrihen përgjatë gjithë infrastrukturës sipas roleve që kanë përdoruesit.
- Izolim dhe privatësi, trafiku i një segmenti nuk shihet nga segmentet e tjera.
- Adresim IP dhe grupime përdoruesish në bazë të funksioneve dhe jo pikave gjeografike ku ata lidhen në rrjet.
- Lehtësi zgjerimi/shkallëzimi sipas nevojave.

Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me një rrjet me shumë përdorues dhe shtrirje gjeografike të madhe nevojiten një ndarje dhe segmentim granular i rrjetit. Segmentimi duhet të ndajë rrjetin në pjesë më të vogla dhe duhet të kontrollojë mënyrën e lëvizjes së trafikut midis këtyre pjesëve duke e bllokuar atë ose duke lejuar vetëm tipe të veçanta trafiku.

Nga këto teknika të segmentimit të rrjetit synohet të përftohen:

- Përmirësimi i performancës, i cili redukton ngarkesat në rrjet. Trafiku i rrjetit wireless segmentohet nga trafiku i përdoruesve apo trafikut drejt internetit në mënyrë që ato të mos ndikohen nga njëri-tjetri. Në këtë mënyrë secili trafik ka prioritetin e vet.
- Limiton pasojat në rast sulmesh kibernetike, duke qenë se segmentet nuk komunikojnë ose komunikojnë vetëm nëpërmjet firewall-it. Ky lloj konfigurimi ndihmon në izolimin e sulmeve dhe bllokun përhapjen e tyre në rrjet.

Rrjeti wireless do të përshkallëzohet duke shtuar pajisje akses point nëpër degë për të patur mbulim më të madh. Trafiku i përdoruesve në rrjetin wireless duhet të kalojë i koduar dhe i tuneluar përgjatë rrjetit dhe të filtrohet në firewall përpara se të rrugëzohet në pjesën tjetër të rrjetit.

Çdo përdorues që akseson rrjetin e OST qoftë ai i kablluar ose wireless duhet të manaxhohet nga një sistem i centralizuar politikash. Aktualisht janë në përdorim 500 licensa (licensë që shërben për çdo pajisje me adresë fizike “MAC address” unike, e cila lidhet në rrjetin wired/wireless) të sistemit të centralizuar të politikave. Për ta shtrirë sistemin e centralizuar të politikave edhe në pajisjet e degëve nevojitet të shtohen edhe licensa të tjera. Kjo shërben për të evituar gabimet njerëzore dhe për të lehtësuar konfigurimet në rastet kur trafiku kalon nëpër shumë pajisje.

3.2 Përdoruesit

Zgjidhja duhet të jetë lehtësisht e përshtatur për të gjitha llojet e pajisjeve fundore duke ofruar siguri dhe fleksibilitet në konfigurime pa ndikuar në eksperiencën e përdoruesve të rrjetit.

3.3 Adresimi IP

Adresimi i nyjeve të reja do të ruajë të njëjtën skemë adresimi logjik. Nevojitet adresimi i nyjeve të reja të rutimit nga pika në pikë midis pajisjeve të rrjetit dhe subnetet e krijuara për të akomoduar përdoruesit dhe pajisjet e ndryshme të institucionit. Ndarja e rrjetit fizik dhe trafikut të përdoruesve nëpër tunele komunikimi private në varësi të rolit të tyre.

5. PAJISJE DHE SISTEME

Nevojitet një arkitekturë rrjeti e ndërtuar me pajisje që janë kompatibël me njëra-tjetrën për të ofruar një integrim të plotë midis tyre. Duhet që agregimi dhe politikat e sigurisë mbi trafikun e përdoruesve të jenë të unifikuara dhe të centralizuara për të lehtësuar konfigurimet dhe kohën e shpenzuar nga stafi TI për të bërë monitorime dhe ndryshime në rrjet. Duke qenë se kemi të bëjmë me një rrjet që përfshin disa pika periferike, nevojitet vizibilitet dhe kontroll mbi pajisjet fundore dhe informacionin se ku janë lidhur në rrjet.

Pajisje të tipit Switch

Pajisje që suportojnë switchim trafiku me shpejtësi të lartë (uplink dhe agregim 10GbE), të suportojnë protokolle routimi dhe teknologji stakimi për të ofruar performancë dhe disponueshmeri të lartë. Këto pajisje duhet të shërbejnë për agregimin e gjithë trafikut dhe rrugëzimin e informacionit. Për të siguruar redundancë dhe backup të komunikimit, switchet duhet të jenë të stakuar me njëri-tjetrin. Të jetë i mundur kalimi automatik dhe funksional nga njëri switch tek tjetri në rast bllokimi ose defekti të njërit prej tyre.

• **Data Center Switch – Sasia 2 copë**

Data Center Switch	
Forma fizike	Rack mounted, 1 rack unit, aksesoret e perfshire
Porta/Ndërfaqet	<ul style="list-style-type: none"> • Minimalisht 48 porta SFP+ (1/10G Base-X); • Minimalisht 6 porta 40Gb që suportojnë transeivera QSFP+ • 1 portë me transeiver elektrik menaxhimi 1 x 10M/100M/1000MBASE-T • 1 portë SFP+ menaxhimi • 1 portë Console (USB ose RJ-45)
Memoria	<ul style="list-style-type: none"> • 1 Gb flash; • 4 GB SDRAM; • Madhësia e Packet buffer: 12 MB;
Throughput/Performanca	<ul style="list-style-type: none"> • 714 Mpps throughput; • Kapacitet për Switchim/Rutim: 1400 Gbps; • Tabela e rutimit: 16K (IPv4), 8K (IPv6); • Tabela e adresave MAC: 208K; • Vonesa (latency) më e vogël se 1.5 µs (porta 10 Gbps); • Lista kontroll aksesi: ACL hyrëse(ingress) 68K;
Power	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësirë për 2 blloqe ushqimi; • Të jetë i pajisur me 2 blloqe ushqimi AC
Disponueshmëria	<ul style="list-style-type: none"> • Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në gjashtëmbëdhjetë pajise në një stack, duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen; • Teknologji e avancuar për ndërlidhjen për standarded OAM, BFD, ECMP, VRRP; IRF
Karakteristikat e shtresës L2	<ul style="list-style-type: none"> • Të suportojë standardin IEEE 802.1Q, minimumi 1000 VLAN ID dhe standardin IEEE 802.1ad QinQ; • Bashkim portash 10GbE që lejon grupimin dhe shfrytëzimin më të mirë të linjave për të rritur sasinë e transmetimit; • Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad); • Spanning Tree – STP, MSTP, RSTP; • Kontroll mbi trafikun Multicast me anë të protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping; • Voice VLAN, Multicast VLAN; • LLDP, LLDP-MED;

Data Center Switch	
	<ul style="list-style-type: none"> • Support për Jumbo frame 10000 bytes
Karakteristikat e shtresës L3	<ul style="list-style-type: none"> • Switchim dhe ACL me shpejtësi wire (media); • Të suportojë rutim ne IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP; • Të suportojë rutim në IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+; • Të ofrojë ndërfaqe të adresueshme Loopback; • Standartet për tunelim te IPv6 mbi IPv4; • Rutim ne Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM; si dhe ofron mundësi për menaxhim te adresave multicast dhe frenim të sulmeve DoS; • Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara; • DHCP Server, Relay; • Tunelim GRE per VPN që mundëson tunelim te Layer2 mbi Layer3;
Karakteristika të avancuara për rrjetin	<ul style="list-style-type: none"> • Të suportojë MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE; • Virtual Private LAN Service (VPLS); • Të suportojë VxLAN • Rutim Policy-based; • Route maps për kontroll më të mirë në shpërndarjen e rutimeve;
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> • Të suportojë lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrime trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri ne L4; • Të suportojë për ACL globale, në VLAN dhe në portë; • Të suportojë ACL ne hardware me TCAM; • Menaxhim me SSH, HTTP (TLS), SNMP V1, SNMP v2c, SNMPv3 dhe me server qendror të tipit RADIUS dhe TACACS; • Të ofrojë mbrojte nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP snooping
Cilësia e Shërbimit (QoS)	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS); • Të suportojë funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter; • Të suportojë standartet: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);

Data Center Switch	
	<ul style="list-style-type: none"> • Të ofrojë limitim të trafikut të tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast të panjohur;
Manaxhimi	<ul style="list-style-type: none"> • Konfigurim në distancë në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, Web UI, ruajtje logesh • Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit të operimit, një primar dhe një sekondar (për backup); • Ruan në disa versione filet e konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuar; • Port mirroring me aftësi për të përzgjedhur në bazë ACL trafikun hyrës/dalës nga një portë ose një VLAN dhe të pasqyrojë atë në një portë lokale ose në remote • SNMP v2c and v3; NTPv3;
Licensimi	Pajisja Switch do të jetë e licensuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
Garancia	1 vit suport nga prodhuesi si dhe përditësimet e softuerit të përfshira

- **Switch në nyje (HQ dhe Njesi Operative) – 10 copë**

Switch në nyje	
Forma fizike	Rack mounted, 1 rack unit, aksesorët e përfshirë
Porta/Ndërfaqet	<ul style="list-style-type: none"> • Minimumi 48 porta RJ-45 PoE+(10/100/1000 Base-T); • 6 porta 10Gb që suportojnë transceivera SFP+; • 1 portë Console (USB ose RJ-45) • Mundësi për 1 portë shtesë console të dubluar RJ-45 ose USB
Memoria	<ul style="list-style-type: none"> • 4 Gb flash ; • 1 GB SDRAM; • Madhësia e Packet buffer: 12 MB;
Throughput/Performanca	<ul style="list-style-type: none"> • Arkitektura non-blocking, të ofrojë switchim wire-speed; • 112 Mbps throughput; • Kapacitet për Switchim/Rutim: 176 Gbps; • Tabela e rutimit: 2K (IPv4), 1K (IPv6); • Tabela e adresave MAC: 32K;

Switch në nyje	
	<ul style="list-style-type: none"> • Vonesa (latency) më e vogël se 3.8 μs (porta 1Gbps Mb); • Vonesa (latency) më e vogël se 1.6 μs (porta 10Gbps Mb); • Lista kontroll aksesi: ACL hyrëse (ingress) 32K;
Power	<ul style="list-style-type: none"> • Të jetë i pajisur minimalisht me 1 bllok ushqimi AC
Disponueshmëria	<ul style="list-style-type: none"> • Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në tetë pajisje në një stack, duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen; • Teknologji e avancuar për ndërlidhjen për standardet VSF • Përditësim i pajisjes gjatë punës (In service software upgrade);
Karakteristikat e shtresës L2	<ul style="list-style-type: none"> • Të suportojnë standardin IEEE 802.1Q, minimumi 1000 VLAN ID dhe standardin IEEE 802.1ad QinQ; • Bashkim portash me kapacitet Gb lejon grupimin dhe shfrytëzimin më të mirë të linjave për të rritur sasinë e transmetimit; • Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad); • Spanning Tree – STP, MSTP, RSTP; • Kontroll mbi trafikun Multicast me anë të protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping; • Voice VLAN, Multicast VLAN; • LLDP, LLDP-MED; • Support për Jumbo frame 9220 bytes
Karakteristikat e shtresës L3	<ul style="list-style-type: none"> • Switchim dhe ACL me shpejtësi wire (media); • Të suportojnë rutim në IPv4 sipas standardeve: CIDR, Static routing, RIP, OSPF dhe BGP • Të suportojnë rutim në IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 • Të ofrojnë ndërfaqe të adresueshme Loopback; • Standartet për tunelim të IPv6 mbi IPv4; • Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP të duplikuara; • DHCP Server, Relay
Karakteristika të avancuara për rrjetin	<ul style="list-style-type: none"> • Ofron VxLAN • MVRP (Multiple Vlan Registration Protocol) • Rutim Policy-based;

Switch në nyje	
	<ul style="list-style-type: none"> ● Route maps për kontroll më të mirë në shpërndarjen e rutimeve; ● Të suportojnë IRDP (ICMP Router Discovery Protocol)
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> ● Lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrime trafiku duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri në L4; ● Të suportojnë ACL globale, në VLAN dhe në portë; ● Të suportojnë ACL në hardware me TCAM; ● Menaxhim me SSH, HTTP (TLS), SNMP V1, SNMP v2c, SNMPv3 dhe me server qendror të tipit RADIUS dhe TACACS; TACACS+ ● Të ofrojnë mbrojtje nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP snooping
Cilësia e Shërbimit (QoS)	<ul style="list-style-type: none"> ● Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar në: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS); CoS (Class of Service) ● Të suportojnë funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter; ● Të suportojnë standardet: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin); ● Të ofrojnë limitim të trafikut të tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast të panjohur;
Manaxhimi	<ul style="list-style-type: none"> ● Konfigurim në distancë në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, Web UI, ruajtje logesh; HPE IMC ● Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit të operimit, një primar dhe një sekondar (për backup); ● Ruan në disa versione file të konfigurimit që lejojnë kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuar; ● Port mirroring e aftësi për të përzgjedhur në bazë ACL trafikun hyrës/dalës nga një porte ose një VLAN dhe të pasqyrojë atë në një portë lokale ose në remote; RSPAN, ERSPAN ● SNMP v2c and v3; NTPv3;
Licensimi	Pajisja Switch do të jetë e licensuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
Garancia	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim të pajisjes në ditën vijuese të punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit të përfshira

Pikat e aksesit wireless (pa kablo)

Nevojitet mbulimi me sinjal WI-FI për degët. Ky rrjet do t’u shërbejë përdoruesve të degëve për akses drejt internetit. Çdo trafik i gjeneruar nga këta përdorues duhet të trajtohet konform limitimeve dhe rregullave të institucionit. Përdoruesit duhet të klasifikohen në bazë të funksioneve që kanë dhe duhet të aplikohen politika të veçanta nga një sistem qendror. Trafiku i përdoruesve

duhet të kalojë i tuneluar për tek kontrollerat dhe të filtrohet në firewall përpara se të rrugëzohet në rrjet. Këto pajisje duhet të ofrojnë protokollet më të reja të industrisë për momentin.

● **Access Point – 10 copë**

Access Point	
Forma fizike	Access Point për përdorim në ambiente të brendshme (Indoor) me antenë të integruar shumë-drejtimëshe
Porta/Ndërfaqet	<ul style="list-style-type: none"> ● Minimalisht 1 portë RJ-45 PoE (10/100/1000 Base-T) ● Minimalisht 1 portë USB
Frekuencat/Bandwidth	<ul style="list-style-type: none"> ● 2.4 Ghz (minimalisht 300 Mbps) ● 5 Ghz (minimalisht 867 Mbps)
Protokollet e Data Link	Të suportojnë standartet: <ul style="list-style-type: none"> ● IEEE 802.11b ● IEEE 802.11a ● IEEE 802.11g ● IEEE 802.11n ● IEEE 802.11ac
Modulimi	<ul style="list-style-type: none"> ● Të ofrojnë modulimet: CCK, 64 QAM, 256 QAM, BPSK, QPSK, 16 QAM, OFDM
Multipleksimi	<ul style="list-style-type: none"> ● Të suportojnë OFDM (Orthogonal frequency-division multiplexing) ● DSSS (Direct sequence spread spectrum)
Fuqia	<ul style="list-style-type: none"> ● Të jetë i pajisur me një burim ushqimi DC
Kapaciteti	<ul style="list-style-type: none"> ● Të suportojnë minimalisht 250 klientë wireless për WI-FI radio ● Të suportojnë 16 BSSID për radio
Karakteristikat	<ul style="list-style-type: none"> ● Negocim porte duke përdorur MDX/MDI-X ● Të suportojnë QoS (Quality of Service) ● Të suportojnë DFS (Dynamic Frequency Selection) ● Të sigurojnë në hardware TPM ● Teknologji antene MIMO ● MRC (Maximum Ratio Combining) ● LDPC (Low Density Parity Check) ● TxBF (Transmit Beam-forming) ● Bluetooth Low Energy Beacon ● CDD (Cyclic Delay Diversity) ● STBC (Space Time Blocking Code)

Access Point	
	<ul style="list-style-type: none"> • ACC (Advanced Cellular Coexistence) • CSD (Cyclic Shift Diversity)
Licensimi	Pajisja Access Point do të jetë e licencuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet më sipër.
Garancia	1 vit nga prodhuesi

Arkitektura e rrjetit, automatizimi, segmentimi dhe centralizimi i trafikut

Përshkallëzimi i pajisjeve të reja të rrjetit duhet të integrohet me sistemin aktual, i cili është i pajisur me një cluster kontrollorash për të mbledhur të gjithë trafikun që vjen nga përdoruesit në tunele të veçanta. Këto pajisje kanë firewall të integruar për të aplikuar politikat që vijnë nga sistemi i centralizuar për politikat e sigurisë. Duke qenë se këto politika janë të bazuara në tipin e përdoruesve dhe jo në pajisjen ku ato lidhen, kjo sjell lehtësime në konfigurime duke eliminuar nevojën e akses listave ose VLAN-eve në switche apo krijimin e rrjetave wireless të veçanta për çdo departament apo grupim përdoruesish. Ky segmentim trafiku duhet të unifikojë aplikimin e politikave mbi çdo përdorues pavarësisht mënyrës se si ai e akseson rrjetin duke ofruar siguri dhe ndarje midis tyre. Kjo lejon që në të njëjtin rrjet fizik të ekzistojnë tipe të ndryshme pajisjesh (kompjutera, akses point, guest) dhe që nuk mund të ndikojnë tek funksionet e njëra-tjetrës.

Përdorimi i këtyre teknologjive të reja duhet të automatizojë dhe të zgjidhë një sërë problematikash për manaxhimin e rrjeteve tradicionale siç janë:

- Krijimi i VLAN-eve dhe zgjerimi i tyre tek çdo switch ku nevojitet.
- Konfigurimet manuale tek portat e secilit switch.
- Aplikimi i listave të aksesit të veçanta tek çdo switch.
- Ndërhyrje manuale në konfigurimin e portave sa herë që një pajisje zhvendoset.
- Mungesa e vizibilitetit për pajisjet që tentojnë të aksesojnë rrjetin.
- Krijimi i rrjetave wireless të veçanta me fjalëkalim dhe ndryshimi i shpeshtë i tyre.

Politikat e sigurisë të unifikuara për përdoruesit

OST ka të implementuar një sistem qëndror për menaxhimin e unifikuar për politikat e aksesit për përdoruesit wireless dhe të kablluar. Ky sistem luan rolin kyç në orkestrimin dhe manaxhimin e aksesit për përdoruesit e rrjetit të OST. Kjo platformë i mundëson stafit TI një ndërfaqe të centralizuar për krijimin e politikave, bazuar në profilet e përdoruesve dhe tipet e pajisjeve dhe më

pas të aplikohen në mënyrë automatike. Ky sistem duhet të identifikojë të gjitha pajisjet që aksesojnë rrjetin, të mbledhë të dhëna dhe të krijojë një profil për secilën prej tyre. Këto të dhëna më pas përdoren tek politikat e sigurisë për të automatizuar dhe siguruar aksesin në rrjet. Siç është përmendur më sipër, OST ka një sistem Administrimi dhe Menaxhimi për politikat e aksesit të licensuar për 500 përdorues/pajisje.

Për të përfshirë dhe pajisjet/përdoruesit në degë, duhen minimalisht 500 licensa të tjera për sistemin e centralizuar të politikave të aksesit.

Sistemi aktual është ndërtuar në zgjidhjen Aruba ClearPass Policy Manager Platform.

Përshkrimi	Sasia
JZ399AAE - Aruba ClearPass Cx000V VM Appl E-LTU	1
JZ401AAE - Aruba ClearPass NL AC 500 CE E-LTU	1
JZ437AAE - HPE Aruba Licenses ClearPass NL OB 500 USR E-LTU	1
JZ473AAE - HPE Aruba Licenses ClearPass NL OG 500 EP E-LTU	1

Software

Duhet të bëhet furnizimi dhe implementimi i të gjithë software-ve të nevojshëm për pajisjet dhe realizimin e rrjetit, duke përfshirë programet e ndryshme të konfigurimit, protokollet e nevojshme, etj.

Të gjithë software-t duhet të jenë të pajisur me licensat e nevojshme.

6. DOREZIMI, TESTIMI DHE DOKUMENTACIONI PËRFUNDIMTAR

Projekti do të zbatohet dhe dorezohet si një “turn key solution”, ku kontraktori do të kryej instalimet jo vetëm në Aparat Qendror por dhe në Njesi Operative. Në përfundim të projektit duhet të kryhet testim final i të gjithë sistemit. Duhet parashikuar të gjitha pajisjet dhe aparatet testuese të nevojshme dhe të gjitha testimet duhet të bëhen nga zbatuesi i projektit.

Zbatuesi në përfundim të projektit duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin përfundimtar, “AS BUILT”, në të cilin duhet të jenë:

Projekti i zbatimit (përfundimtar)

- Specifikimet e pajisjeve
- Diagramat
- Konfigurimet përfundimtare të pajisjeve
- Çertifikatat e pajisjeve
- Lista e pajisjeve dhe materialeve të furnizuara

Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo në Specifikiet Teknike ku është cituar standard nderkombetar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Switch Data Center	Copë	2
2	Switch-e në Nyje	Copë	10
3	Access Point	Copë	10
4	Licensa shtesë për sistemin NAC (500 përdorues)	Set	1
5	Implementim i projektit	Komplet	1

Afatet e lëvrimit: 1 (një) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Zgjerim i infrastrukturës së rrjetit informatik ekzistues dhe komunikimi me ENTSO-E, sipas specifikimeve teknike (Shtojca 5)		OST sh.a.	1 (një) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 26,000,000 (njetzet e gjashte milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 10,000,000 (dhjete milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi (Switche, Access Points si dhe sistemin e monitorimit dhe menaxhimin të rrjetit). Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
- 2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*
- *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të këto lidhje me objektin e prokurimit.*
 - *ISO 27001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekti i së cilës të këto lidhje me objektin e prokurimit.*
- 2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit (të perkthyer dhe noterizuar) për mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*
- 2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues, për kryerjen e shërbimit të implementimit të projektit, duhet të ketë në stafin e tij punonjës të certifikuar nga prodhuesit e pajisjeve ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, për shërbimet që do ofrohen. Punonjësit duhet të jenë të certifikuar si më poshtë:*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional për dizejnimin e rrjetit, ose ekuivalent.*
 - *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional për pajisjet e rrjetit të tipit switch, ose ekuivalent.*
 - *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemin e menaxhimit, monitorimit të pajisjeve, implementimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet, ose ekuivalent.*
 - *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisjet e rrjetit të tipit access points (wi-fi), ose ekuivalent.*

Shënim: *Një punonjës mund të ketë me shumë se një certifikatë.*

Punonjësit e mesipër duhet të jenë pjesë e OE prej të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë: CV-të, listëpagesat e-Sig për periudhën e kërkuar, certifikatat përkatëse, kontratat e punës.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

- 2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se: Mallrat objekt procedure prokurimi janë të reja dhe të pa përdorura më parë.*
- 2.3.7 *Në funksion të plotësimit të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmenden “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

